

FTESË PËR SESIONE INFORMUESE

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin trevjeçar (2020-2022): *“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës”*, i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe bashkëfinancuar nga komunat partnere.

Projekti do të kontribuoj që fermerët, gratë, të rinjtë, studentët, grupet e marginalizuara dhe minoritetet, përmes aktiviteteve përkrahëse me grante, punë praktike dhe aftësim profesional, të krijojnë kushte për aktivitete bujqësore apo biznesore, të cilat mundësojnë krijimin e të hyrave, punësimit dhe përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të tyre.

Në kordinim me komunat është planifikuar koha dhe vendi i mbajtjes së sesioneve informuese, andaj për informata më të hollësishme në lidhje me aktivitetet e projektit dhe mundësit e aplikimit, ftohen të interesuarit nga grupet e lartcekura që të marrin pjesë në këto takime, që do të mbahen sipas tabelës vijuese:

Orari i sesioneve informuese nëpër komuna				
Nr.	Komuna	Vendi i mbajtjes	Data	Ora
1	Vushtrri	Zyret e IADK-së, Sfaraçak i Ulët	25.01.2022	10:00
2	Skënderaj	Salla e Kuvendit Komunal Skënderaj	25.01.2022	14:00

Sinqerisht,

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv i IADK-së